

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 107/2016, “PËR

PREFEKTIN E QARKUT”

I. QËLLIMI I PROJEKT AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107 datë 27.10.2016 “Për prefektin e qarkut” synon përforcimin i rolit të prefektit të qarkut, misionit dhe kompetencave në përmbushje të detyrave të tij, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në qark.

Domosdoshmëria e ndryshimeve ligjore, për ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e qarkut” ka lindur si nevojë për të rritur efikasitetin dhe konsolidimin e performancës së prefektit të qarkut, për ofrimin e shërbimeve më cilësore, për një qeverisje gjithmonë e më pranë qytetareve, si dhe përforcimit të rolit të tij në qark.

II. VLERËSIMI I PROJEKT AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj lidhet me realizimin e programit të Këshillit të Ministrave dhe është i parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve për Ministrinë e Brendshme për vitin 2023.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji rregullon problemet e evidentuara nga zbatimi i ligjit të aktual “Për Prefektin e Qarkut”, në lidhje me:

- Përcaktimin e saktë të akteve normative të organeve të vetëqeverisjes vendore, objekt i verifikimit të ligjshmërisë;

- Shoqërimi i akteve normative me relacion përmbledhës të arsyeve për nxjerrjen e tyre duke argumentuar mbi problematikat, qëllimet, objektivat që synohen të arrihen, përparësitë si dhe efektet e pritshme nga miratimi;
- Përcaktimin e saktë kritereve të emërimit;

Ndër përparësitë e projektligjit, vlen të përmendet:

- Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre;
- Me propozim të prefektit të qarkut ngrihen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore Këshillat Vendor të Sigurisë Publike (KVSP), për kryerjen e funksioneve të veçanta për rendin dhe sigurinë publike në komunitet;
- Për shqyrtimin e problematikave mbi sigurinë publike në komunitet të identifikuar nga KVSP-të, krijohet dhe funksionon Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet (KKSK);
- Përbërja, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të KVSP dhe KKSK, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- Në raste të veçanta, në përputhje me legjislacionin përkatës, prefekti i drejtohet ministrit të Mbrojtjes për angazhimin e njësive të Forcave të Armatosura dhe kërkon mbështetje për përballimin e detyrave me karakter civil dhe në veçanti në përballimin e situatave të emergjencave civile e të krizave;
- Prefekti i qarkut i drejton kërkesë për mbështetje AKMC-së, sipas kërkesës së bërë nga bashkitë;
- Koordinimi në nivel qarku i veprimeve në terren të njësive të Forcave të Armatosura, bazuar në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, për realizimin e detyrave me karakter civil;
- Është parashikuar zëvendësimi i prefektit nga nënprefekti, sipas Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;
- Është parashikuar se papajtueshmëritë e funksionit të prefektit zbatohen edhe për nënprefektin.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, sipas të cilit ndër të tjera përcaktohet se, *“Këshilli i Ministrave merr vendime për përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës shtetërore”*, vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”*.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT AKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT AKTIT

Projektligji i propozuar përmban ndryshimet dhe shtesat si vijojnë:

✓ Në nenin 1 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 4 (Përkufizime), pika 1 ndryshohet përkufizimi i akteve normative, me qëllim evidentimin e saktë që në pjesën hyrëse të ligjit të akteve që nxjerrin organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, si vijon:

“1. “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njehershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.”

✓ Në nenin 2 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 6 (Kriteret e emërimit), pas shkronjës ‘ç’ shtohet shkronja ‘d’ si vijon:

“d) nuk është larguar nga detyra ose nuk i është hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë tjetër disiplinore në fuqi;

✓ Në nenin 3 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 8 (Përgjegjësitë kryesore të prefektit të qarkut), bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën “a”, fjalët ‘vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave’ zëvendësohet me fjalën ‘akteve’.

2. Pas shkronjës ‘j’ shtohen shkronjat I) dhe II) si vijojnë:

I) “përcjelljen e kërkesës së arsyetuar për fillimin e inspektimit, pranë institucioneve të ngarkuara me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.”;

II) ndërmerrjen e nismave dhe propozimeve për dhënien e titujve të nderit për persona me kontribut të veçantë në qark, sipas legjislacionit në fuqi;

✓ Në nenin 4 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 10 (Marrëdhëniet e prefektit të qarkut me degët territoriale), bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rast të ndryshimeve strukturore të degëve territoriale apo drejtorive të ministrive në qark, ndryshimet i bëhen me dije prefektit të qarkut.”

✓ Në nenin 5 të projektligjit parashikohet se:

Pas nenit 12 (Detyra në lidhje me organet e Policisë së Shtetit), shtohet neni 12/1, me këtë përmbajtje:

“1. Me propozimin e Prefektit të qarkut pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, ngrihen Këshillat Vendor të Sigurisë Publike (KVSP), për kryerjen e funksioneve të veçanta për rendin dhe sigurinë publike në komunitet.”

“2. Për shqyrtimin e problematikave mbi sigurinë publike në komunitet të identifikuara nga KVSP, krijohet dhe funksionon Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet (KSK).”

“3. Përbërja, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet (KSK), përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

✓ Në nenin 6 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 13 (Detyra në lidhje me strukturat e mbrojtjes), bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet në *“Detyrat për mbrojtjen civile”*.

2. Pika e parë numërohet me numrin 1 dhe pas pikës 1, shtohen pikat 2 dhe 3, si vijon:
“2. Prefekti i qarkut i drejton kërkesë për mbështetje AKMC-së, sipas kërkesës së bërë nga bashkitë.

3. Prefekti i qarkut koordinon në nivel qarku, veprimet në terren të njësive të Forcave të Armatosura, të cilat angazhohen bazuar në deklaratimet në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, me qëllim realizimin e detyrave me karakter civil, që u ngarkohen sipas legjislacionit në fuqi.

✓ Në nenin 7 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 16, (Verifikimi i ligjshmërisë së akteve) pika 2, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 2, formulohet si vijon:

“2. Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e mëposhtme:”

2. Në shkronjën “a”, të pikës 2, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:

“Aktet me karakter normativ shoqërohen me një relacion përmbledhës të arsyeve për nxjerrjen e tyre, duke argumentuar mbi qëllimin, objektivat që synohen të arrihen, problematikat, përparësitë si dhe efektet e pritshme nga miratimi.”.

✓ Në nenin 10 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 18, (Verifikimi i përgjegjësive të deleguara) pika 1, fjalët *“sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave”*, hiqen.

✓ Në nenin 8 të projektligjit parashikohet se:

Në nenin 18 (Verifikimi i përgjegjësive të deleguara), pika 1, fjalët *“sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave”*, shfuqizohen.

✓ Në nenin 9 të projektligjit parashikohet se

Në nenin 22 (Nënprefekti) bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1, shtohen pikat 1/1 dhe 1/2, si vijon:

“1/1. Nënprefekti zëvendëson prefektin, sipas Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

“1/2. Parashikimet e nenit 7, të këtij ligji, mbi papajtueshmëritë e funksionit të prefektit, zbatohen edhe për nënprefektin.

✓ Në nenin 10 të projektligjit parashikohet nxjerrja e akteve nënligjore, si vijon:

Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të miratojë aktin nënligjor në zbatim të pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji.

✓ Në nenin 11 të projektligjit parashikohet hyrja në fuqi, si vijon:

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen me zbatimin e projektligjit prefektët e qarqeve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Ministrit të Brendshëm, nr. 58, datë 28.04.2023 “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

Fillimisht projektligji dhe relacioni shoqërues është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-akte pranë:

- Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,
- Ministrisë së Arsimit dhe Sportit,
- Ministrisë së Drejtësisë,
- Ministrisë së Mbrojtjes.

➤ **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, të datës 10.10.2023, është shprehur si vijon:

1- Në këndvështrimin buxhetor

- Vlerësojmë se projektligji shoqërohet me kosto të shtuara buxhetore të cilat lidhen më shtimin e strukturës së kabinetit, thirrjen e ekspertëve të jashtëm dhe funksionimin e task-forcave. *Ky koment është reflektuar plotësisht duke u hequr nga përmbajtja e projektligjit struktura e kabinetit dhe thirrja e ekspertëve të jashtëm.*

Lidhur me procedurën e monitorimit të zbatimit të politikave, sipas nenit 3 të projektligjit, mbetet e paqartë nëse kjo veprimtari shoqërohet me kosto të shtuara buxhetore. *Shpjegimi është dhënë në paragrafin lidhur me nenin 3, shkronja “k”.*

Sa më sipër, kërkojmë të paraqitet një analizë paraprake e kostove potenciale që implikon në tërësi zbatimi i projektligjit, si dhe të shprehet qartë burimi i financimit të tyre, e detajuar në nivel artikulli/produkti dhe programi buxhetor. Për sa i përket funksionimit të task-forcave kërkojmë të sqarohet se si është parashikuar mënyra e funksionimit të tyre. *Është reflektuar komenti i Ministrisë Drejtësisë duke u hequr pikat 5 dhe 6, që synohet të shtohen në nenin 14, pasi në çdo rast krijimi i task-forcave, me ligj apo akte nënligjore, shoqërohet edhe me rregullimin e mbështetjes financiare për përmbushjen e detyrave të tyre.*

Sjellim në vëmendje, që në tavanet buxhetore përfundimtare 2024-2026, nuk ka të parashikuar financim të politikave të reja lidhur me propozimet e bëra në projektligj, dhe për më tepër nuk janë paraqitur si pjesë e kërkesave shtesë gjatë fazës strategjike

dhe teknike të përgatitjes së dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, nga institucioni përgjegjës. ***Ky koment është reflektuar plotësisht duke u hequr nga përmbajtja e projektligjit, duke lënë në fuqi nenin 21 të ligjit aktual.***

- Lidhur me nenin 3, germa k), ku përcaktohet se: “Prefekti monitoron zbatimin e projekteve, programeve sektoriale në qark, që zhvillohen me fonde të kushtëzuara apo fonde të qeverisë qendrore...”, kërkojmë të sqarohet se cilave projekte i referohet kjo dispozitë, për sa kohë që edhe fondet e kushtëzuara që i akordohen Njësive të Vetëqeverisjes Vendore janë pjesë e buxhetit të shtetit ose buxhetit të ministrive përkatëse të linjës. ***Është reflektuar komenti i Ministrisë së Drejtësisë, duke u hequr shkronja “k” nga përmbajtja e projektligjit, pasi neni 8 në fuqi, i jep mundësinë prefektit që të monitorojë zbatimin e projekteve dhe programeve, jo vetëm në rastet kur ato zhvillohen me fonde të kushtëzuara apo fonde të qeverisë qendrore dhe jo vetëm për respektimin e afateve dhe cilësisë. Këtë monitorim ai e kryen përmes zbatimit të shkronjave “a”, “b”, “e”, dhe “g” të nenit 8 të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut” (në vijim, ligji për prefektin).***

- Lidhur me nenin 10 të projektligjit, ku përcaktohen kompetenca e prefektit përsa i përket monitorimit të përmbushjes së standardeve kombëtare, sjellim në vëmendje se përcaktimet lidhur me sistemin e performancës apo raportin vjetor të performancës së shërbimeve publike duhet të jenë në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, duke mbajtur në konsideratë që aktualisht Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore hartojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre si dhe përgatisin raportet periodike të monitorimit, në zbatim të ligjit nr. 68/2017.

Sa më sipër, detyrat e prefektit duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke mos cenuar funksionet/detyrat apo autonominë që kanë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në përgatitjen e raporteve të monitorimit të buxhetit/performancës buxhetore. ***Është reflektuar komenti i Ministrisë së Drejtësisë, duke u hequr neni 10 i projektligjit. Është bërë numërtimi rendor i neneve.***

2- Në aspektin e përmbajtjes shprehemi si më poshtë:

- Në nenin 2 të projektligjit përcaktohet zëvendësimi i fjalës “shtetasi” me fjalën “kandidati”, në nenin 6 të ligjit. Vlerësojmë së ky zëvendësim nuk është i nevojshëm, për sa kohë nuk lidhet me një procedurë në të cilën janë prezent disa kandidat, kjo edhe në analogji me nenin 11/3 të ligjit ku prefekti i qarkut bën propozimin për drejtuesin e degës territoriale në qark, me jo më pak se dy kandidatura. ***Ky koment është reflektuar plotësisht.***

3. Lidhur me nenin 3, germa k), ku përcaktohet se: *“Prefekti monitoron zbatimin e projekteve, programeve sektoriale në qark, që zhvillohen me fonde të kushtëzuara apo fonde të qeverisë qendrore...”*, kërkojmë të sqarohet se cilave projekte i referohet kjo dispozitë, për sa kohë që edhe fondet e kushtëzuara që i akordohen Njësive të Vetëqeverisjes Vendore janë pjesë e buxhetit të shetit ose buxhetit të ministrive përkatëse të linjës. ***Për këtë sugjerim shkronja “k” është hequr nga përmbajtja e projektligjit sipas komentit të Ministrisë së Drejtësisë. Janë hequr gjithashtu shkronja “m” dhe pika 2.***

- Në nenin 3 të projektligjit përcaktohet që në nenin 8, shkronja j) të ligjit, në fund të fjalisë shtohet togfjalëshi “apo marrëveshje të veçanta”. Kërkojmë të sqarohet se çfarë kuptohet me marrëveshje të veçanta. ***Ky koment është reflektuar plotësisht duke u hequr togfjalëshi “apo marrëveshje të veçanta”.***

- ***Neni 4 i projektligjit përcakton shtesa në nenin 10***, ku pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4 më këtë përmbajtje:

‘3. Në rast të ndryshimeve strukturore të degëve territoriale apo drejtorive të ministrive në qark, ndryshimet i bëhen me dije prefektit të qarkut.’

‘4. Në prezantimin e drejtuesit të ri merr pjesë edhe prefekti i qarkut’.

- ***Neni 5 i projektligjit shfuqizon nenin 11 të ligjit***, *“Propozimet për emërim dhe lirim të drejtuesve të degëve territoriale”*, ***pasi nuk ka gjetur zbatim në praktikë, për faktin së këto marrëdhënie pune janë rregulluar me ligjet e veçanta sektoriale.***

- Lidhur me nenin 15 të projektligjit, ku përcaktohet shtimi i pikës 1/1, në nenin 20 të ligjit, për ngritjen e grupeve të punës me urdhër të prefektit të qarkut, sjellim në vëmendje se referuar nenit 24, të ligjit nr. 90/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”*, grupet e punës të përbashkëta ngrihen me urdhër të përbashkët të ministrave të përfshirë, ose në rast mosmarrëveshje me urdhër të kryeministrit. ***Ky koment u reflektua plotësisht duke u hequr pika 1/1 në nenin 20 të ligjit.***

- Në nenin 16 të projektligjit parashikohet e drejta e prefektit të qarkut për të thërritur ekspertë të jashtëm. Lidhur me këtë përcaktim, kërkojmë të sqarohet në relacion se cilat mund të jenë rastet që është e nevojshme të thërriten ekspertë të jashtëm. ***Ky koment është reflektuar plotësisht, duke u hequr nga përmbajtja e projektligjit dhe duke lënë në fuqi nenin 21 të ligjit aktual.***

- Në nenin 17 të projektligjit, parashikohet të hiqet pika 4, e nenit 22 të ligjit në të cilën përcakohet se: *“Pranë nënprefektit funksionojnë zyrat e ankesave të qytetarëve”*. Kërkojmë të sqarohet në relacionin shpjegues nëse këto zyra funksionojnë aktualisht,

Relacion shpjegues për projektligjin *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”*

dhe si parashikohet të vijohet me paraqitjen e ankesave nga ana e qytetarëve. ***Për këtë koment, pika 4 lihet në fuqi: “4. Pranë nënprefektit funksionojnë zyrat e ankesave të qytetarëve”.***

Në aspektin e teknikës legjislativë shprehemi si më poshtë:

- Në nenin 3, pika 2 të projektligjit përcaktohet se: “...kudo në ligj hiqet togfjalëshi “krijimin e organizmave të përkohshëm””, ndërsa në nenin 9, pika 1 të projektligjit përcaktohet se: “Kudo në këtë nen hiqet togfjalëshi “organizmave të përkohshëm””. Sugjerojmë që të bëhet harmonizimi i këtyre neneve, duke shmangur të njëjtin parashikim në disa nene. ***Është reflektuar sugjerimi për nenin 3, pika 2 të projektligjit, duke u hequr fjalët “krijimin e organizmave të përkohshëm”, ndërsa në nenin 9, pika 1 të projektligjit përcaktimi se: “Kudo në këtë nen hiqen fjalët “organizmave të përkohshëm”, është hequr.***

- Në nenin 5, pika 3, përcaktohet se: “Në pikën 2, para togfjalëshit ‘aktet e nxjerra’ shtohet togfjalëshi ‘zyrtarisht, të nesërmen pas miratimit të tyre’”. Sugjerojmë korigjimin e kësaj reference ose togfjalësi, pasi në nenin 10, pika 2 nuk ka togfjalësh me përmbajtjes “aktet e nxjerra”. ***Ky nen është hequr nga përmbajtja e projektligjit, duke bërë edhe numrtimin rendor të neneve.***

➤ **Ministria e Drejtësisë** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, të datës 06.10.2023, është shprehur si vijon:

1. Mbi ligjshmërinë e formës dhe përmbajtjes

1.1 Të hiqet shkronja “dh” që synohet të shtohet në nenin 6, pasi në çdo rast parashikimet e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, zbatohen jo vetëm për shkak se vetë ky ligj e parashikon prefektin si subjekt të ndalimit për t’u emëruar apo zgjedhur në funksionet publike dhe është drejtpërdrejt i zbatueshëm, por njëkohësisht për shkak se është një ligj që ka epërsi për shkak të miratimit të tij me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. ***Ky koment është reflektuar plotësisht.***

1.2 Shtimi i togfjalëshit “*së formës dhe përmbajtjes*” në shkronjën “a”, të nenit 8, si dhe në dispozitat e tjera të ligjit, sjell një kufizim të kompetencës së prefektit në lidhje me verifikimin e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore. Për analogji, Ministria e Drejtësisë, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 584/2003, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, nuk shprehet vetëm në lidhje me ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes, por edhe për çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legjislativë dhe për terminologjinë juridike të projektaktit. Në kushtet kur edhe këto dy elementë janë pjesë e rëndësishme e

ligjshmërisë së aktit, në drejtim të qartësisë së normës dhe parimit të sigurisë juridike, sugjerohet që të mos shtohet ky togfjalësh. ***Ky koment është reflektuar plotësisht.***

1.3 Në vijim edhe të komenteve të dhëna më herët, shkronja “k” që synohet të shtohet në nenin 8 të hiqet nga përmbajtja e projektvendimit pasi, monitorimi i zbatimit të projekteve dhe programeve sektoriale në qark, është një kompetencë që, megjithëse jo në mënyrë të shprehur, ligji ia ka njohur prefektit. Neni 8 në fuqi, i jep mundësinë prefektit që të monitorojë zbatimin e projekteve dhe programeve, jo vetëm në rastet kur ato zhvillohen me fonde të kushtëzuara apo fonde të qeverisë qendrore dhe jo vetëm për respektimin e afateve dhe cilësisë. Këtë monitorim ai e kryen përmes zbatimit të shkronja “a”, “b”, “e”, dhe “g” të nenit 8 të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut” (në vijim, ligji për prefektin). Ndërkohë, autorizimi mbi përcaktimin me vendim të Këshillit të Ministrave të procedurës së monitorimit të zbatimit të politikave sektoriale, përfshirë për projektet dhe programet sektoriale, që zhvillohen me fonde të kushtëzuara apo fonde të qeverisë qendrore, mund të shtohet si një pikë më vete në nenin 8. ***Ky sugjerim është reflektuar plotësisht, duke u hequr nga përmbajtja e projektligjit shkronja k dhe pika 2.***

1.4 Sa i përket shtimit të shkronjës “l”, në nenin 8, të ligjit për prefektin, sillet në vëmendje komenti i dhënë më parë në lidhje me këtë çështje dhe se evidentimi i shkeljes është në kompetencë të organit të ngarkuar me ligj, për mbikëqyrjen e veprimtarisë së ushtruar, si dhe monitorimin e zbatimit të ligjit përkatës. Në këto kushte, prefekti nuk mund të evidentojë/konstatojë shkelje, pasi për të evidentuar nëse ka ndodhur apo jo shkelje, duhet të kryejë një hetim administrativ. Prefekti i qarkut, nuk e ka këtë kompetencë, por sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 10, ndjek kërkesat dhe ankesat e shtetasve deri në zgjidhjen e tyre, kurse sipas pikës 3, të nenit 19 informohet për konfliktet që lindin ndërmjet institucioneve dhe shtetasve, në nivel qarku dhe ka detyrimin vetëm për të adresuar konfliktin pranë institucioneve përgjegjëse. Në këto kushte, shkronja “l”, të riformulohet si vijon: *“përcjelljen e kërkesës së motivuar për fillimin e inspektimit, pranë institucioneve të ngarkuara me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, vetëm pasi ka vlerësuar të gjithë informacionin e siguruar, në raport me disponimet ligjore në fuqi, që tregojnë se ka të dhëna të besueshme se është kryer një shkelje e ligjit.”*. ***Ky sugjerim është reflektuar plotësisht.***

1.5 Të rishikohet parashikimi në këtë ligj i kompetencës për dhënien e certifikatave të nderit për persona me kontribut të veçantë në qark, në kushtet kur dhënia e titujve vendorë të nderit është parashikuar në ligjin nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, ku në nenin 11, parashikohet kompetenca e prefektit të qarkut për të propozuar dhënien e titullit vendor të nderit. ***Ky koment është reflektuar duke e riformuluar “ndërmerr nishta dhe propozime për dhënien e titujve të nderit për persona me kontribut të veçantë në qark”, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, neni 11, shkronja “c”.***

1.6 Në vijim edhe të komenteve të dhëna më herët në lidhje me këtë çështje, të hiqen pikat 5 dhe 6, që synohet të shtohen në nenin 14, pasi në çdo rast krijimi i task-forcave, me ligj apo akte nënligjore, shoqërohet edhe me rregullimin e mbështetjes financiare për përmbushjen e detyrave të tyre. ***Ky koment është reflektuar plotësisht.***

1.7 Në lidhje me shtimin e pikës 4, në nenin 15, sillet në vëmendje se sipas pikës 1, të nenit 13 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, kompetencën për monitorimin e përmbushjes së standardeve kombëtare nuk e ka prefekti, por ministritë, të cilat sipas fushave të përgjegjësisë, monitorojnë veprimtarinë e organeve të njëjste të vetëqeverisjes vendore dhe për funksionet e deleguara kanë të drejtë t’i mbikëqyrin ato. Në këto kushte, dhënia e kësaj kompetence edhe prefektit të qarkut sjellë si pasojë lindjen e konfliktit të kompetencave. Monitorimi i përmbushjes së standardeve kombëtare, përfshihet në kompetencat e prefektit të parashikuar nga neni 8 dhe neni 18, i ligjit për prefektin. Sa më sipër, sugjerohet heqja e nenit 10 nga projektligji. ***Ky koment është reflektuar plotësisht duke bërë dhe numërtimin rendor të neneve.***

1.8 Në kushtet kur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, parashikohet se padia kundër aktit nënligjor normativ duhet të paraqitet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të aktit, të hiqet pika 3, e nenit 12 të projektligjit. ***Për këtë koment janë hequr neni 12 dhe 13 të projektligjit duke bërë dhe numërtimin rendor të neneve. Pas këtyre ndryshimeve neni 13 i projektligjit bëhet neni 9 duke u riformuluar: Në nenin 18, pika 1, fjalët “sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave”, hiqen.***

Është hequr gjithashtu nga përmbajtja e projektligjit neni 14.

1.9 Në lidhje me shtimin e pikës 1/1, në nenin 20 të ligjit për prefektin, Ministria e Drejtësisë i qëndron mendimit të dhënë më parë për heqjen e saj. ***Për këtë koment është hequr neni 15 projektligjit duke bërë dhe numërtimin rendor të neneve.***

1.10 Pika 1/2, që synohet të shtohet në nenin 21, është e paqartë pasi nuk përcakton se për cilat funksione dhe përgjegjësi prefekti i qarkut thërret ekspertë të jashtëm dhe procedurën sesi përzgjidhen ekspertët. Nga ana tjetër, është e paqartë sesi nënprefekti do të mbikëqyrë shërbimin e ofruar. Sipas neneve 21 dhe 22, në veprimtarinë e tij, prefekti mbështetet nga administrata dhe nënprefektët dhe sipas projektligjit do të mbështetet edhe nga kabineti. ***Për këtë koment është hequr nga përmbajtja e projektligjit neni 16 duke lënë në fuqi nenin 21 të ligjit aktual. Është bërë numërtimi rendor të neneve.***

1.11 Sa i përket rregullimit të marrëdhënies së punës sipas dispozitave të Kodit të Punës së anëtarëve të kabinetit të prefektit, sillet në vëmendje se sipas pikës 3, të nenit 4 të ligjit nr. 9000 datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, si dhe pikës 1, të nenit 17 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të punësuarit e kabineteve gëzojnë statusin

e funksionarit politik. Në këto kushte, pika 5 e nenit 16, të projektligjit të hiqet. ***Për këtë koment është hequr nga përmbajtja e projektligjit neni 16 duke lënë në fuqi nenin 21 të ligjit aktual. Është bërë numërtimi rendor të neneve.***

2. Mbi çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legislative

2.1 Në kushtet kur përkufizimi për termin akte normative është dhënë nga pika 2, e nenit 3 të Kodit të Procedurave Administrative dhe pika 3, e nenit 2 të ligjit nr. 49/2012, si dhe parashikimi i dhënë në pikën 1, të nenit 4 të ligjit për prefektin nuk rezulton të ketë ndonjë paqartësi apo kundërshti me këto dispozita, rezulton se ndryshimi i përkufizimit të termit “akte normative” në ligjin për prefektin e qarkut është i panevojshëm. Për më tepër, përkufizimi i ri i këtij termi, nuk përmban të gjithë elementët e përcaktuar nga KPA dhe ligji nr. 49/2012. Megjithatë, nëse ndryshimi i këtij përkufizimi është i domosdoshëm, me qëllim përputhshmërinë me përkufizimin e dhënë nga KPA dhe ligji nr. 49/2012, pika 1 e nenit 4, të riformulohet si vijon: ***“Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që rregullojnë një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes, nuk janë të shteruar në zbatimin e tij, si dhe që kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial të organeve të vetëqeverisjes vendore”.*** ***Ky koment është reflektuar plotësisht.***

2.2 Shtimi i togfjalëshit “*të paktën*” në shkronjën c, të nenit 6 të ligjit për prefektin, nuk sjell ndonjë ndryshim krahasuar me kushtin që parashikohet nga dispozita aktualisht në fuqi, pasi edhe sipas kësaj të fundit, parashikohet vetëm një kufi minimal i përvojës së punës në administratën publike. Kjo dispozitë nuk ndalon emërimin e një shtetasi si prefekt edhe nëse ka përvojë më të gjatë në administratën publike. ***Ky koment është reflektuar plotësisht.***

2.3 Në kushtet kur edhe largimi nga puna është në vetvete masë disiplinore, si dhe me qëllim qartësimin e zbatimit të normës edhe për masat e tjera disiplinore, në shkronjën “d”, të pikës 3, pas togfjalëshit “*të mos ketë masë*” të shtohet fjala “*tjetër*”. ***Ky koment është reflektuar plotësisht.***

2.4 Pika 3, e nenit 5, të zhvendoset në nenin 4 të projektligjit, pasi togfjalëshi “*zyrtarisht, të nesërmen pas miratimit të tyre*” duhet të shtohet në pikën 2, të nenit 9 të ligjit për prefektin. ***Për këtë koment, pas numërtimit neni 5 bëhet neni 4 dhe hiqen përcaktimet e dhëna duke u formuluar si vijon: Në nenin 10 bëhen këto shtesa:***

1. Pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Në rast të ndryshimeve strukturore të degëve territoriale apo drejtorive të ministrive në qark, ndryshimet i bëhen me dije prefektit të qarkut.”

“4. Në prezantimin e drejtuesit të ri merr pjesë edhe prefekti i qarkut”.

- Neni 5 i projektligjit shfuqizon nenin 11 të ligjit, “Propozimet për emërim dhe lirim të drejtuesve të degëve territoriale”, pasi nuk ka gjetur zbatim në praktikë, për faktin së këto marrëdhënie pune janë rregulluar me ligjet e veçanta sektoriale.

2.5 Në kushtet kur sipas shkronjës “d”, të nenit 10 prefekti i qarkut harton çdo fund viti raportin mbi bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë me degët territoriale që veprojnë në qark, dhe ua paraqet ministrive përgjegjëse dhe Kryeministrit, shtimi i pikës 3 në këtë nen duket i panevojshëm. Pavarësisht përdorimit të termit “monitorim” në këtë pikë, në çdo rast ky monitorim do të bëhet vetëm në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 10 dhe në përfundim i njëjti raportim mund të përmbajë të dhëna mbi monitorimin e degëve territoriale. Ndërkohë, edhe sa i përket ndryshimeve strukturore të degëve territoriale të drejtorive të ministrive, ligji e parashikon këtë njoftim në pikën 2 të këtij neni. Në këto kushte, sugjerohet që të kryhen ndryshime në këtë pikë me qëllim që të parashikohet detyrimi për njoftimin edhe të ndryshimeve eventuale strukturore të degëve territoriale apo drejtorive të ministrive në qark. ***Për këtë koment, pas numërimit neni 5 bëhet neni 4 dhe hiqen përcaktimet e dhëna duke u formuluar si vijon Në nenin 10 bëhen këto shtesa:***

1. Pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Në rast të ndryshimeve strukturore të degëve territoriale apo drejtorive të ministrive në qark, ndryshimet i bëhen me dije prefektit të qarkut.”

“4. Në prezantimin e drejtuesit të ri merr pjesë edhe prefekti i qarkut”

2.6 Fjalja hyrëse e nenit 8 të riformulohet si vijon: *“Në nenin 13, “Detyra në lidhje me strukturat e mbrojtjes” bëhet numërtimi rendor i nenit, si dhe shtohen pikat 2 dhe 3, si vijon:”. Është reflektuar komenti i Ministrisë së Mbrojtjes, si vijon: Neni 6*

Në nenin 13 titulli aktual “Detyra në lidhje me strukturat e mbrojtjes”, ndryshohet “Detyrat për mbrojtjen civile”, paragrafi aktual bëhet pika 1, si dhe shtohen pikat 2 dhe 3, si vijon:

3. Në raste të veçanta, në përputhje me legjislacionin përkatës, prefekti i drejtohet ministrit të Mbrojtjes për angazhimin e njësisë të Forcave të Armatosura dhe kërkon mbështetje për përballimin e detyrave me karakter civil dhe në veçanti në përballimin e situatave të emergjencave civile e të krizave.

2. Prefekti i qarkut i drejton kërkesë për mbështetje AKMC-së, sipas kërkesës së bërë nga bashkitë.

3. Prefekti i qarkut koordinon në nivel qarku, veprimet në terren të njësisë të Forcave të Armatosura, të cilat angazhohen bazuar në deklaratimet në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, me qëllim realizimin e detyrave me karakter civil, që u ngarkohen sipas legjislacionit në fuqi.

2.7 Shtimi i nënpikës “v” në shkronjën “b”, të pikës 2 të nenit 16, është i panevojshëm në kushtet kur përmes përkufizimit të dhënë për aktet me karakter normativ, si dhe dispozitave të ligjit për prefektin në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së akteve, është qartësisht e kuptueshme se aktet me karakter individual nuk duhet t’i dërgohen

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”

prefektit për verifikim, dhe nëse i dërgohen, prefekti, duke mos pasur kompetencën për verifikimin e ligjshmërisë së tyre, nuk shprehet mbi to. ***Ky koment është reflektuar duke u hequr pika 1 dhe nënpika “v”, në shkronjën “b”, pika 2 e nenit 16.***

2.8 Fjalja që synohet të shtohet në fund të pikës 3, të nenit 19, të shtohet në fund të pikës 1 të këtij neni. ***Ky koment u reflektua plotësisht, duke mos bërë ndryshime në nenin 19. Është bërë numërtimi rendor i neneve.***

2.9 Pika 2, e nenit 17 të projektligjit, të riformulohet si vijon: “2. Pika 4 shfuqizohet”. ***Ky koment nuk është reflektuar, duke e lënë pikën 4 në fuqi: “4. Pranë nënprefektit funksionojnë zyrat e ankesave të qytetarëve”.***

- **Ministria e Arsimit dhe Sportit** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, të datës 03.10.2023, është shprehur parimisht dakort, duke sugjeruar si vijon:

Neni 2 i projektligjit të saktësohet pasi ka dy pika me numër tre. Ku për pikën tre që i takon të jetë pika katër sugjerojmë se shkronja “d” të rishikohet, duke pasur në konsideratë se edhe masa disiplinore e largimit nga puna është masë disiplinore që përfshihet tek referimi për të gjitha masat disiplinore në tërësi, prandaj sugjerojmë riformulimin e kësaj shkronje si vijon:

“d) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.” Është reflektuar sugjerimi i Ministrisë së Drejtësisë.

- **Ministria e Mbrojtjes** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, të datës 16.10.2023, është shprehur parimisht dakort, duke sugjeruar si vijon:

1. Titulli/emërtimi i nenit 13 të ligjit aktual “Detyra në lidhje me strukturat e mbrojtjes”, të ndryshohet dhe të bëhet “Detyrat për mbrojtjen civile”. ***Ky koment është reflektuar plotësisht.***

2. Pika 2, e nenit 8 të riformulohet në përputhje me ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” (neni 28, pika 2, germa “ll”), ku përcaktohet se “Prefekti i qarkut drejton kërkesë për mbështetje AKMC-së, sipas kërkesës së bërë nga bashkitë”. ***Ky koment është reflektuar plotësisht.***

3. Pika 3, e nenit 8 të riformulohet:

“Prefekti i qarkut koordinon në nivel qarku, veprimet në terren të njësive të Forcave të Armatosura të cilat angazhohen, bazuar në deklaratimet në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, me qëllim realizimin e detyrave me karakter civil që u ngarkohen sipas legjislacionit në fuqi”. ***Ky koment është reflektuar plotësisht.***

Projektligji është dërguar për mendim nëpërmjet e-mailit të datës 12.09.2023, pranë Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, por edhe për përfshirjen në mbledhjen e radhës së Këshillit Konsultativ, duke qënë në rolin e Sekretariatit Teknik të këtij këshilli.

Gjithashtu projektligji është dërguar për mendim nëpërmjet e-mailit të datës 15.09.2023, pranë:

- Shoqatës për Autonomi Vendore;
- Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë.

➤ **Shoqata për Autonomi Vendore dhe Shoqata e Qarqeve të Shqipërisë** në mbledhjen e datës 05.10.2023 të Këshillit Konsultativ, me vendimin nr. 5, datë 25.10.2023, kanë shprehur komentet e tyre, të cilat në tërësi janë të njëjta me komentet e **Ministrisë së Drejtësisë**. *Në këtë pikë janë reflektuar komentet e kësaj të fundit.*

Projektligji dhe relacioni shoqërues pas reflektimit të komenteve, është dërguar për bashkërendim nëpërmjet sistemit E-Akte pranë:

- Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,
- Ministrisë së Arsimit dhe Sportit,
- Ministrisë së Drejtësisë,
- Ministrisë së Mbrojtjes,
- Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor.

➤ Nëpërmjet sistemit E-Akte kanë shprehur dakortësinë e tyre Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Mbrojtjes.

➤ **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** në shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit E-Akte, të datës 19.12.2023, është shprehur si vijon:

1- Në këndvështrimin buxhetor

- Në draftin e ripunuar të projektligjit, parashikohet ngritja e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet, për të cilët vlerësojmë se, ngritja e tyre shoqërohet minimalisht me kosto për burime njerëzore shtesë, pa marrë në konsideratë kostot e funksionimit të tyre.

Sa më sipër, në relacion të sqarohen kostot e ngritjes dhe funksionimit të këtyre këshillave, si dhe burimi i financimit. *Lidhur me këtë koment nuk parashikohen efekte financiare në buxhetin e shtetit dhe në burime njerëzore shtesë.*

KVSP-të do të jenë organizma koordinues, identifikues dhe konsultues me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet, të cilët mblidhen minimalisht 1 (një) herë në 3 muaj. KVSP-ja do të përbëhet nga anëtarët, të cilët do të jenë përfaqësues të institucioneve qendrore që veprojnë në nivel vendor (në bashkitë përkatëse ku do të ngrihen KVSP-të).

KKSK-ja do të jetë organ kolegjal që do të kryesohet nga Ministria e Brendshme dhe do të ketë në përbërje të saj anëtarë të institucioneve në nivel qendror.

Mbledhjet e KKSK-së do të zhvillohen si rregull 2 herë në vit.

- Në nenin 10 të projektligjit, propozohet që në nenin 18, pika 1 të ligjit nr. 107/2016, të hiqet togfjalëshi “...sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave”. Në këto kushte, mbetet e paqartë se cilave rregulla do ti referohet prefekti, për verifikimin e realizimit të funksioneve e të përgjegjësive të deleguara nga pushteti qendror dhe përdorimin e fondeve të parashikuara për këto funksione.

Sa më sipër, të sqarohet në mënyrë ezauresive se pse është e nevojshme të hiqet ky përcaktim dhe se si do të vijohet me tej me procedurën e verifikimit nga prefekti i qarkut. Në vlerësimin tonë, ky rregullim nuk duhet të ndryshohet. ***Për këtë koment togfjalëshi “...sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave”, është hequr pasi nuk ka gjetur zbatim në praktikë, për faktin se nga miratimi i ligjit e deri më sot nuk ka dalë ndonjë vendim i Këshillit të Ministrave dhe se këto marrëdhënie janë rregulluar me ligjet e veçanta sektoriale nga ministritë, të cilat kanë deleguar funksionet e tyre.***

- Referuar nenit 7, pika 2, të projektligjit ku përcaktohet se: “*Prefekti i qarkut i drejton kërkesë për mbështetje AKMC-së sipas kërkesës së bërë nga bashkitë*”, vlerësojmë se duhet të përcaktohen në mënyrë eksplicite rastet se kur prefekti i drejtohet AKCM-së. Gjithashtu, është e nevojshme të sqarohet se si është proceduar deri tani për këto raste. ***Për këtë koment, neni 7 i projektligjit ka riformuluar nenin 13 të ligjit aktual, sipas sugjerimeve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), si institucione lider në rastet e emergjencave civile. Neni 1 në fuqi, i ligjit aktual, parashikon se “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rolit të prefektit të qarkut, misionit të tij dhe kopetencave në përmbushje të detyrave të tij, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në nivel qarku”. Gjithashtu neni 8 në fuqi, i jep përgjegjësinë prefektit të qarkut për drejtimin e task-forcave, apo strukturave për parandalimin, menaxhimin dhe rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile. Këto përgjegjësi ai e kryen përmes zbatimit të shkronjave “dh” dhe “e” të nenit 8 “Përgjegjësitë kryesore të prefektit të qarkut”, të ligjit nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut” (në vijim, ligji për prefektin).***

Në çdo rast, sjellim në vëmendjen tuaj, që çdo kosto potenciale që implikon zbatimin e projektvendimit, duhet të garantohet dhe përballohet brenda tavaneve buxhetore për institucionet përgjegjëse. ***Lidhur me këtë pikë, ky projektligj nuk parashikohet të ketë efekte financiare në buxhetin e shtetit.***

➤ **Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor** në shkresën me nr. 34. Prot, datë 17.01.2024, është shprehur si vijon:

1. Përsa i takon ndryshimeve në neni 8, nëpërmjet shtesës pas gërmës ‘j’ të gërmës 1) me përmbajtje “*përcjelljen e kërkesës së motivuar për fillimin e inspektimit, pranë institucioneve të ngarkuara me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, vetëm pasi ka vlerësuar*

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”

*të gjithë informacionin e siguruar, në raport me disponimet ligjore në fuqi, që tregojnë se ka të dhëna të besueshme se është kryer një shkelje e ligjit.”, vlerësojmë që ky parashikim duhet të saktësohet dhe qartësohet më tej në përputhje me parimin e siurisë juridike për sa i takon ndaj cilave orgave mund të kërkojë prefekti të iniciohet inspektim. **Lidhur me këtë pikë, është reflektuar komenti i Ministrisë së Drejtësisë: përcjelljen e kërkesës së arsyetuar për fillimin e inspektimit, pranë institucioneve të ngarkuara me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.***

2. Në lidhje me ndryshimet në nenin 16, pika 2, gërma a) me anë të të cilave shtohet detyrimi për organet e vetëqeverisjes vendore për të paraqitur përpara prefektit një relacion shoqërues për aktet me karakter normativ që ata miratojnë, vlerësojmë që organet nuk duhen të ngarkohen me përgjegjësinë për të hartuar relacion të posaçëm në kuadër të vlerësimit që kryen prefekti. **Lidhur me këtë pikë, sqarojmë se:**

Relacioni përmbledhës i vjen në ndihmë prefektit për tu njohur me qëllimin e projektaktit dhe objektivat që synohen të arrihen dhe argumentimin e propozimit të projektaktit, mbi analizën lidhur me përparësitë dhe problemet e mundshme në zbatimin e projektaktit, nivelin e efektivitetit, zbatueshmërisë, efikasitetit, impaktit dhe efekteve përkatëse, që rezultojnë në raport me legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu sqarojmë se çdo akt me karakter normativ që nxjerrin organet e vetëqeverisjes vendore shoqërohen gjithmonë me relacionin përkatës dhe për këtë arsye nuk ngarkohen me përgjegjësi të shtuar për hartim relacioni.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk parashikohet të ketë efekte financiare në buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI

TAULANT BALLA

